



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. 4207/prot.

Përmet, më 30.12.2025


Lënda : Kthim Përgjigje

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015, "Për Vetëqeverisjen Vendore" ,i ndryshuar ; Ligji Nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit" ,i ndryshuar ,nisur nga kërkesa juaj për informacion Nr.144/25 Prot protokolluar me tonën Nr.4207 Prot , datë 16.12.2025, ju bëjmë me dije si më poshtë :

Për periudhën 01.01.2025-12.12.2025 Inspektoriati Vendor i Mbrojtjes së Teritorit Bashkia Përmet ka konstatuar 1 (një) rast ndërtimi pa leje,i cili është referuar për trajtim Drejtorisë Rajonale të IKMT Gjirokastrë për vazhdimin e procedurave ligjore të mëtejshme. Referuar Ligjit Nr.9780, datë 16.7.2007 "Për Inspektimin dhe Mbrojtjen e Territorit nga Ndërtimet e Kundërligjshme", për marrjen e masave administrative apo masave për prishje objekti në rastin kur konstatohen ndërtime pa leje, nevojiten minimalisht tre inspektorë në strukturën e Inspektoriatit Vendor të Mbrojtjes së Territorit. Momentalisht Bashkia Përmet nuk disponon strukture të plotësuar të sektorit IMT dhe për rrjedhojë çdo rast konstatimi të ndërtimeve të kundërligjshme, deri në plotësimin e kësaj strukture, i referohen për trajtim Drejtorisë Rajonale të IKMT Gjirokastrë si dhe vihet në dijeni Inspektoriati Kombëtar i Mbrojtjes së Territorit . Duke ju falenderuar për bashkëpunimin!

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA

Në mungesë dhe në porosi
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Denisa DUKURRO



Sheshi "Abdyl Frashëri", tel. +35581322254, e-mail: info@bashkiapermet.gov.al, www.bashkiapermet.gov.al



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PËRMET

Nr. 4353/1 prot.

Përmet, më 12.01.2026

Lënda : Kthim Përgjigje

Në zbatim të Ligjit Nr.139/2015 , "Për Vetëqeverisjen Vendore" , i ndryshuar ; Ligji Nr.119/2014, "Për të Drejtën e Informimit , i ndryshuar, nisur nga kërkesa juaj për informacion datë 30.12.2025 ,protokolluar me tonën Nr.4353 Prot ,datë 30.12.2025,ju bëjmë me dije si më poshtë:

Investimi me objekt "Bënja - Destinacioni Ndërkombëtar Turistik", zhvillohet në territorin e fshatit Bënjë, Njësia Administrative Petran, Bashkia Përmet, me Investitor dhe zhvillues Fondin Shqiptar të Zhvillimit.

Gjurma e projektit ndodhet brenda kufijve të Parkut Kombëtar Bredhi i Hotovës - Dangëlli, të përcaktuara në Vendimin Nr. 59, datë 26.1.2022 "Për miratimin e ndryshimit të statusit dhe të sipërfaqes së ekosistemeve natyrore Park Kombëtar (Kategoria II) të Zonave të Mbrojtura Mjedisore".

Referuar Ligjit Nr. 81/2017 "Për Zonat e Mbrojtura", i ndryshuar, Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura (AKZM) është institucioni publik qendror që drejton dhe administron veprimtarinë e ruajtjes e të menaxhimit të të gjitha zonave të mbrojtura mjedisore në Republikën e Shqipërisë.

Për informacion më të detajuar lidhur me këtë investim, mund ti drejtoheni Fondit Shqiptar të Zhvillimit si institucioni financues dhe zhvillues i këtij projekti.

Duke ju falenderuar për bashkëpunimi!

KRYETAR I BASHKISË
Alma HOXHA

Në mungesë dhe me porosi
SEKRETAR I PËRGJITHSHËM
Demisa DURRO

Sheshi "Abdyr Frasheri", tel.+355(0)3222154, e-mail: info@bashkiapermet.gov.al, www.bashkiapermet.gov.al

